



AVOKATI I POPULLIT

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT  
Seksioni i Veçantë

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

Nr. Prot.  
Nr. Dok. 202000727/2

Tiranë \_\_\_/\_\_\_/2020

**Lënda:** *Rekomandohet zbatimi i procedurës për dhënien e masës disiplinore ndaj punonjësit të policisë së burgjeve (rasti i ish punonjësit A. P.) si dhe ndryshimi i Urdhrit të Ministrit të Drejtësisë Nr. 3125/1, datë 4.9.2009 "Për miratimin e rregullores "Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për marrëdhënien e punës, trajnimin, ecurinë në karrierë dhe dhënien e masave disiplinore për punonjësit e policisë së burgjeve".*

**DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË BURGJEVE**

**Tiranë**

**MINISTRISË SË DREJTËSISË**

**Tiranë**

*Të nderuar,*

Në Institucionin e Avokatit të Popullit ka paraqitur ankesë shtetasi A. P., ish Shefi i Policisë së Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale Korçë, i cili pretendon se nuk janë respektuar kriteret ligjore për tre masat disiplinore që janë dhënë ndaj tij. Më konkretisht, ky shtetas shpjegon se, ndaj tij janë dhënë tre masa disiplinore njëra pas tjetrës në vitin 2018: "vërejtje me paralajmërim", "pezullim një muaj pa të drejtë page" dhe "largim nga detyra". Për të tre masat e dhëna nuk është respektuar procedura ligjore pasi, nuk është bërë analiza e ngjarjes, ai nuk është thirrur për t'u dëgjuar dhe mbrojtur, nuk është njohur me arsyet ku mbështeten masat dhe nuk i është vënë në dispozicion materiali përfundimtar. Lidhur me këtë situatë ai është ankuar në muajin Nëntor 2018 në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve dhe në Komisionin e Apelit të Masave Disiplinore në Ministrinë e Drejtësisë, por nuk ka marrë përgjigje. Më pas i është drejtuar Zyrës së Bashkëqeverisjes si dhe institucionit të Avokatit të Popullit në Maj 2019.

Për verifikimin e kësaj ankese u jemi drejtuar për t'u informuar nëse është marrë në shqyrtim ankimimi i ish punonjësit të policisë A. P. si dhe kemi kërkuar të na vihet në dispozicion praktika e tre masave disiplinore të dhëna ndaj tij.<sup>1</sup>

Ministria e Drejtësisë na ka vënë në dispozicion përgjigjen që i ka kthyer A. P. me shkresën nr.A-10/4, datë 23.07.2019, ku thuhet:

*“Në përgjigje të kërkesës tuaj, protokolluar pranë nesh me nr. A-10/3, datë 16.07.2019, drejtuar Komisionit të Apelimit të Masave Disiplinore (KAMD), ju sqarojmë se:*

*Për arsye të organizimit të Komisionit të Apelimit të Masave Disiplinore (KAMD), konkretisht largimit të disa anëtarëve të KAMD, nuk u bë i mundur trajtimi i ankesës tuaj të datës 09.11.2018. Duke konsideruar faktin se ankimi në Komisionin e Apelimit të Masave Disiplinore (KAMD), është një ankim administrativ, nga ana jonë nuk mund të trajtohen kërkesat/ankesat, tej afatit të përcaktuar ligjor.*

*Referuar Ligjit Nr.1003, nenit 39 pika 2, Komisioni i Apelimit të Masave Disiplinore (KAMD) ka vetëm kompetencë të lërë në fuqi ose t'i propozojë rishikimin, autoritetit i cili ka dhënë masën disiplinore. Në këtë këndvështrim vendimet e Komisionit të Apelimit të Masave Disiplinore (KAMD) nuk kanë karakter detyrues, por vetëm propozues. Në këto kushte pas kalimit të afatit administrativ, brenda të cilit KAMD duhet të dilte me një vendimmarrje, ankuesi ka të drejtë t'i drejtohet gjykatës kompetente, për rivendosjen e të drejtave të cënuara të pretenduara prej tij.*

*Gjithashtu rezulton se ankesa juaj është trajtuar edhe më parë nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve pasi është përcjellë nga Platforma e Bashkëqeverisjes, dhe për këtë jeni orientuar prej tyre t'i drejtoheni gjykatës, e cila ka kompetencën ligjore për të shfuqizuar/anuluar akte administrative, të cilat ju i mendoni si të padrejta.*

*Lidhur me kërkesën tuaj për një kopje të dokumentacionit që Komisioni i Apelimit të Masave Disiplinore (KAMD) disponon për ankuesin A. P., sqarojmë se disponojmë vetëm ato dokumenta që na janë përcjellë prej jush. Duke qenë se të gjithë procedurën disiplinore si dhe urdhrat përfundimtarë nuk janë dhënë nga ne, por nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, fakt ky i ditur edhe prej jush, ju orientojmë që nëse keni kërkesa për kopje dokumentacioni duhet t'i drejtoheni këtij institucioni.*

*Si konkluzion referuar sqarimeve të mësipërme ju orientojmë të ndiqni procedura të tjera për rivendosjen e të drejtave tuaja legjitime, pasi ankimimi administrativ pranë Komisionit të Apelimit të Masave Disiplinore (KAMD) është ezauruar”.*

Ndërsa, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, me shkresën Nr.780/1 Prot., datë 24.02.2020, na informoi se: *“Ndaj ish punonjësit të rolit të mesëm A. P., Komisioni i Disiplinës në Drejtorinë e Përgjithshme e Burgjeve ka vlerësuar dhënien e 3 masave disiplinore gjatë vitit 2018. Lidhur me masën disiplinore “largim nga detyra”, A. P. ka realizuar ankesa në Ministrinë e Drejtësisë dhe Platformën e Bashkëqeverisjes, në vlerësim të të cilave është thirrur dhe sqaruar sipas procesverbalit Nr.706-A Prot., datë 04.03.2019. Është e vërtetë që nuk ka marrë përgjigje nga KAMD për ankesën e bërë, por i është bërë e njohur e drejta për t'iu drejtuar gjykatës. A. P. ka dërguar çështjen për shqyrtim në Gjykatën Administrative Korçë, të cilës me shkresën Nr.9177, datë 24.12.2019 i është vënë në dispozicion praktika dokumentare”.*

---

<sup>1</sup> Shkresa me Nr. K2/A40-2 Prot., datë 19.06.2019, drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve; Shkresa me Nr. K2/A40-3 Prot., datë 19.06.2019, drejtuar Ministrisë së Drejtësisë; Shkresa me Nr. K2/A40-5 Prot., datë 28.08.2019, drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve; Shkresa me Nr. K2/A40-6 Prot., datë 15.11.2019, drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve; Shkresa me Nr. K2/A40-7 Prot., datë 21.01.2020, drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve.

Bashkëlidhur kësaj përgjigje na është dërguar dokumentacioni i praktikës së tre masave disiplinore. Më poshtë po rendisim këtë dokumentacion për çdo masë sipas radhës, në mënyrë të përmbledhur.

#### **Masa disiplinore “Vërejtje me paralajmërim”**

1. Informacion Nr.4476/1 Prot., datë 11.05.2018 “mbi plan inspektimin Nr.4476, datë 07.05.2018 në IEVP Korçë” drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve nga Drejtori i Policisë.
2. Propozim për dhënie mase disiplinore “Vërejtje me paralajmërim” Nr.Extra Prot., datë 08.05.2018 për K/Komisar A. P. drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve nga Drejtori i Policisë.
3. Masa disiplinore “Vërejtje me paralajmërim” dhënë me Urdhrin Nr.4476/2, datë 18.05.2018, të Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve.

#### **Masa disiplinore “Pezullim pa të drejtë page një muaj”**

1. Shkresa Nr.6877/2 Prot., datë 03.09.2018 “Informacion mbi zbatimin e plan inspektimit Nr.6877, datë 30.08.2018 në IEVP Korçë” drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë nga Drejtori i Policisë së Burgjeve.
2. Shkresa Nr.1599 Prot., datë 03.09.2018 “Dërgohet informacion për shkelje administrative në IEVP Korçë” drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve nga Drejtori i Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Sistemin e Burgjeve.
3. Shkresa Nr.8646/1 Prot., datë 11.09.2018 “Propozim për masë disiplinore” për shefin e policisë K/Komisar A. P. drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve nga Drejtori i Policisë.
4. Masa disiplinore “Pezullim pa të drejtë page një muaj” dhënë me Urdhrin Nr. 8646/6, datë 17.09.2018 të Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve.

#### **Masa disiplinore “Largim nga detyra”**

1. Shkresa Nr.1921 Prot., datë 19.10.2018 “Informacion në lidhje me Shefin e policisë së IEVP Korçë A. P.” drejtuar Ministrit të Drejtësisë nga Drejtori i Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Sistemin e Burgjeve.
2. Masa disiplinore “Largim nga detyra” dhënë me Urdhrin Nr.10858/1, datë 05.11.2018 të Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve.

#### **Kuadri ligjor mbështetës për trajtimin e ankesës.**

Rregullat për procedurën e dhënies së masës disiplinore dhe lirimit nga detyra të punonjësit të policisë së burgjeve përcaktohen në Ligjin Nr.10032, datë 11.12.2008 “Për Policinë e Burgjeve”, dhe Urdhrin e Ministrit të Drejtësisë Nr. Nr. 3125/1, datë 4.9.2009, për miratimin e rregullores “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për marrëdhënien e punës, trajnimin, ecurinë në karrierë dhe dhënien e masave disiplinore për punonjësit e policisë së burgjeve” kreu IV “Masat disiplinore”.

Më konkretisht, në Ligjin Nr.10032, datë 11.12.2008 “Për Policinë e Burgjeve”, i ndryshuar parashikohet si më poshtë:

Neni 23, pikat 2 dhe 3

Lirimi dhe largimi nga Policia e Burgjeve

2. Punonjësi i Policisë së Burgjeve largohet nga detyra nëse dënohet me burgim, me vendim gjyqësor të formës së prerë, **si dhe kur ndaj tij merret masa disiplinore e largimit nga Policia e Burgjeve.**

3. Lirimi ose largimi i punonjësit të Policisë së Burgjeve bëhen me urdhër të titullarit kompetent për emërimin e tij.

Neni 36

Masat disiplinore

1. Kur punonjësi i Policisë së Burgjeve nuk zbaton detyrat e shërbimit ose shkel rregullat e parashikuara në këtë ligj dhe në aktet e tjera, ligjore dhe nënligjore, që lidhen me detyrën dhe këto veprime nuk përbëjnë vepra penale, ndaj tij mund të jepet njëra nga këto masa disiplinore:

a) vërejtje me shkrim;

b) vërejtje me paralajmërim;

c) pezullim pa të drejtë page nga një deri në tre muaj;

ç) ulje në gradë, jo më shumë se një gradë ose funksion deri në 12 muaj;

d) largim nga Policia e Burgjeve.”

2. Masa disiplinore duhet të jetë në përputhje me shkeljen e kryer dhe pasojat e ardhura prej saj.

3. Efektet e masës disiplinore fillojnë pasi të jetë dhënë masa disiplinore nga organi kompetent.

4. Vendimi për masën disiplinore duhet t'i komunikohet me shkrim punonjësit të Policisë së Burgjeve **brenda 5 ditëve pune** nga marrja e tij, duke e vënë në dijeni njëkohësisht edhe për të drejtën e tij të ankimit për vendimin.

5. Kategoritë dhe llojet e shkeljeve disiplinore, kriteret, rregullat, **procedurat dhe dokumentacioni për dhënien e masave disiplinore**, si dhe përbërja, mënyra e organizimit dhe e funksionimit të komisionit të apelimit të punonjësve të Policisë së Burgjeve përcaktohen në **rregulloren e disiplinës.**

Neni 37

Procesi disiplinor

1. Dhënia e masave disiplinore dhe shqyrtimi i tyre bëhen sipas një procedure, e cila garanton të drejtën për t'u vënë në dijeni, për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur.

2. **Për çdo shkelje jepet vetëm një masë disiplinore.** Për vendimin për marrjen e masës disiplinore **njoftohet me shkrim i interesuari**, për të cilin bëhet shënimi përkatës në dosjen vetjake.

Neni 39

Ankimi

1. Punonjësi i Policisë së Burgjeve, ndaj të cilit merret një masë disiplinore, sipas shkronjave "a" e "b" të pikës 1 të nenit 36 të këtij ligji, ka të drejtë të ankohet tek eprori i punonjësit të policisë, që ka dhënë masën ndaj tij, **brenda 5 ditëve nga data e marrjes dijani** për dhënien e masës disiplinore.
2. Punonjësi i Policisë së Burgjeve, ndaj të cilit merret një masë disiplinore, sipas shkronjave "c", "ç" e "d" të pikës 1 të nenit 36 të këtij ligji, **ka të drejtë të ankohet me shkrim në komisionin e apelimit të masave disiplinore në Ministrinë e Drejtësisë, brenda 10 ditëve nga çasti i marrjes dijani me shkrim**, për dhënien e asaj mase.

Sa më sipër, Ligji Nr. 10032, datë 11.12.2008 “*Për Policinë e Burgjeve*”, parashikon se dhënia e masave disiplinore dhe shqyrtimi i tyre bëhen sipas një procedure, e cila garanton të drejtën për t'u vënë në dijeni, për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur. Vendimi për masën disiplinore duhet t'i komunikohet me shkrim punonjësit të Policisë së Burgjeve brenda 5 ditëve pune nga marrja e tij, duke e vënë në dijeni njëkohësisht edhe për të drejtën e tij të ankimit për vendimin, ankim që në varësi të masës disiplinore mund të bëhet tek eprori i punonjësit që ka dhënë masën dhe në komisionin e apelimit të masave në Ministrinë e Drejtësisë. Procedurat më të hollësishme dhe dokumentacioni për dhënien e masave disiplinore përcaktohen në Urdhrin Nr.3125/1, datë 04.09.2009 të Ministrit të Drejtësisë. Referuar këtij Urdhri, procedura e dhënies së masave disiplinore për shkeljet e konstatuara nga vetë strukturat e sistemit të burgjeve duhet të jetë si vijon:

Shkelja e konstatuar i raportohet me shkrim eprorit të punonjësit, i cili pretendohet se ka kryer shkeljen. Ky i fundit vihet në dijeni me shkrim për nisjen e procedurës disiplinore dhe i krijohet mundësia të dëgjohet, të japë variantin e tij të ngjarjes, të thërrasë dëshmitarë që kanë dijeni për ngjarjen. Gjatë shqyrtimit të rastit verifikohet gjithashtu nëse ka procedime disiplinore të mëparshme, saktësia e dokumentacionit, rezultatet në punë, rrethanat rënduese apo lehtësuese. Në përfundim të verifikimit, autoriteti përgjegjës përgatit raportin përfundimtar dhe propozimin për dhënien e masës disiplinore që i paraqitet autoritetit që ka në kompetencë dhënien e masës. Vendimi për dhënien e masës disiplinore duhet të përmbajë: të dhëna për ngjarjen ku bazohet masa disiplinore; referimin ligjor të shkeljes; një listë dhe kopje të të gjitha dokumentave që mbështesin vendimin; të drejtën që ka punonjësi për t'u ankuar dhe afatet e ankimit; nënshkrimin dhe datën që punonjësi ka marrë dijeni për masën disiplinore. Sipas nenit 61 “*Komunikimi i masës*” të Urdhrit Nr.3125/1, datë 04.09.2009 të Ministrit të Drejtësisë, vendimi duhet t'i komunikohet me shkrim vetë punonjësit brenda tri ditëve pune nga marrja e vendimit. Komunikimi bëhet nga eprori i drejtpërdrejtë ose personi i autorizuar prej autoritetit përgjegjës për dhënien e masës disiplinore. Si punonjësi i ndëshkuar, por edhe punonjësi që bën komunikimin nënshkruajnë, me firmë dhe datë, për njoftimin lidhur me dhënien e masës. Punonjësit të ndëshkuar i jepet një kopje e vendimit origjinal, kopje e raportit përfundimtar si dhe dokumentacioni mbështetës. Kur punonjësi i ndëshkuar refuzon të nënshkruajë për marrjen dijani, punonjësi që bën komunikimin vendos shënimin “refuzon firmën”. Për masat e lehta disiplinore, punonjësi i ndëshkuar ka të drejtë të ankohet me shkrim tek eprori i punonjësit që ka dhënë masën, brenda pesë ditëve nga data e marrjes dijani. Ndërsa për masat e rënda disiplinore ka të drejtë të paraqesë ankim me shkrim te Komisioni i Apelimit të Masave Disiplinore në Ministrinë e Drejtësisë, brenda 10 ditëve nga data e marrjes dijani. Kryetari i Komisionit të Apelimit duhet të njoftojë me shkrim punonjësin e policisë për vendin, datën dhe orën e shqyrtimit të ankesës së tij jo më vonë se 5 ditë përpara datës së shqyrtimit. Vendimi i Komisionit duhet të merret jo më vonë se 30 ditë nga momenti i marrjes së ankesës dhe duhet t'i komunikohet me shkrim punonjësit

të policisë dhe autoritetit që ka dhënë masën jo më vonë se 5 ditë pune. Kundër vendimit të Komisionit të Apelit mund të paraqitet ankimi në gjykatë. Masa disiplinore, për të cilën është bërë ankimi nga punonjësi ekzekutohet dhe vendoset në dosjen personale të tij si dhe regjistrohet në sistemin e të dhënave nga strukturat përkatëse të personelit, pasi të jetë marrë vendimi përfundimtar nga eprori, Komisioni i Apelit ose gjykata. Efektet e masës disiplinore fillojnë pasi të ketë përfunduar procesi disiplinor, ku përfshihen procedurat përkatëse të apelit dhe pasi të jetë dhënë vendimi përfundimtar. Në çdo rast, masa disiplinore ekzekutohet brenda 30 ditëve nga komunikimi i saj ose nga marrja e vendimit nga eprori apo Komisioni i Apelit.

Kur punonjësi i policisë është ndëshkuar me masën disiplinore “largim nga detyra”, Komisioni i Apelit i dërgon strukturës përgjegjëse për personelin e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve një kopje të vendimit. Në këtë rast, struktura përgjegjëse për personelin përgatit urdhrin e përjashtimit dhe ndërprerjes së marrëdhënieve financiare me punonjësin. Masa disiplinore nuk mund të jepet nëse nuk i është komunikuar me shkrim punonjësit brenda 5 ditëve pune nga marrja e vendimit. Masa disiplinore nuk ekzekutohet kur nga momenti i ankimit të punonjësit kanë kaluar 60 ditë dhe punonjësit nuk i është njoftuar me shkrim vendimi i Komisionit të Apelit.

Nëse është respektuar procedura ligjore në dhënien e tre masave disiplinore ndaj ish punonjësit të policisë së burgjeve A. P., analizojmë veprimet administrative të kryera duke iu referuar akteve normative që rregullojnë këtë veprimtari.

**Masa disiplinore “Vërejtje me paralajmërim”** është dhënë me urdher të Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve, bazuar në propozimin e Drejtorit të Policisë së Burgjeve dhe informacionin e dhënë për konstatimet e bëra në IEVP Korçë gjatë inspektimit të datës 07.05.2018. Lidhur me këtë masë, në respektim të procedurës së përcaktuar në Urdhrin e Ministrit të Drejtësisë Nr.3125/1, datë 04.09.2009, nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve nuk na është vënë në dispozicion dokumentacioni përkatës si: urdhri për ngritjen e komisionit të disiplinës, njoftimi i punonjësit të policisë për nisjen e procedurës disiplinore, njoftimi për vendin, datën dhe orën ku do të zhvillohej seanca dëgjimore si dhe procesverbali ku të jetë pasqyruar diskutimi i seancës dëgjimore. Propozimi për dhënien e masës disiplinore dhe vendimi i masës disiplinore referojnë bazën ligjore të shkeljes, por nuk përmbajnë të dhëna për ngjarjen dhe nuk rendisin listën e dokumentacionit ku mbështetet masa e marrë. Aty citohet vetëm shkresa që përmban informacionin për konstatimet e inspektimit. Në vendimin e Drejtorit të Përgjithshëm nuk përmendet e drejta e punonjësit për t’u ankuar, afatet e ankimit dhe nuk gjendet nënshkrimi i punonjësit që ka komunikuar vendimin. Vendimi është nënshkruar vetëm nga Adriatik Parisi në datën 22.05.2018, brenda afatit ligjor 5 ditor për komunikimin e vendimit.

**Masa disiplinore “Pezullim pa të drejtë page një muaj”** është dhënë me urdher të Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve, bazuar në propozimin e Drejtorit të Policisë dhe informacionin e dhënë për konstatimet e bëra në IEVP Korçë gjatë inspektimit të datës 30.08.2018. Në lidhje me këtë masë, në respektim të procedurës së përcaktuar në Urdhrin e Ministrit të Drejtësisë Nr.3125/1, datë 04.09.2009, nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve nuk na është vënë në dispozicion dokumentacioni përkatës si: urdhri për ngritjen e komisionit të disiplinës, njoftimi i punonjësit të policisë për nisjen e procedurës disiplinore, njoftimi për vendin, datën dhe orën ku do të zhvillohej seanca dëgjimore si dhe procesverbali ku të jetë pasqyruar diskutimi i seancës dëgjimore. Propozimi për

dhënien e masës disiplinore dhe vendimi i masës disiplinore referojnë bazën ligjore të shkeljes, por nuk përmbajnë të dhëna për ngjarjen dhe nuk rendisin listën e dokumentacionit ku mbështet masa e marrë. Aty citohet vetëm shkresa që përmban informacionin për konstatimet e inspektimit. Në vendimin e Drejtorit të Përgjithshëm nuk përmendet e drejta e punonjësit për t'u ankuar, afatet e ankimit dhe nuk gjendet nënshkrimi i punonjësit që ka komunikuar vendimin dhe nënshkrimi i marrjes dijeni nga Adriatik Parisi.

**Masa disiplinore “Largim nga detyra”** është dhënë me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve, bazuar në informacionin e dhënë nga SHKBB ku pretendohet se A. P. ka kryer një shkelje në datën 14.09.2018. Edhe në këtë rast, si pjesë e praktikës ligjore që duhet ndjekur, nuk na është dërguar dokumentacioni si: urdhri për ngritjen e komisionit të disiplinës, njoftimi i punonjësit të policisë për nisjen e procedurës disiplinore, njoftimi për vendin, datën dhe orën ku do të zhvillohej seanca dëgjimore si dhe procesverbali ku të jetë pasqyruar diskutimi i seancës dëgjimore. Propozimi për dhënien e masës disiplinore është bërë vetëm nga SHKBB, ndërkohë që sipas Ligjit Nr. 10032, datë 11.12.2008 “*Për Policinë e Burgjeve*”, largimi nga detyra e Shefit të Policisë K/Komisar A. P. duhet të ishte bërë sipas propozimit të Drejtorit të Policisë së Burgjeve. Vendimi i masës disiplinore referon bazën ligjore të shkeljes dhe citon informacionin e dhënë nga SHKBB, por nuk përmban të dhëna për ngjarjen, nuk rendit listën e dokumentacionit ku mbështet masa e marrë, nuk përmendet e drejta e punonjësit për t'u ankuar, afatet e ankimit, nuk gjendet nënshkrimi i punonjësit që ka komunikuar vendimin dhe nënshkrimi i marrjes dijeni nga A. P.

Shtetasi A. P. ka bërë ankim në Komisionin e Apelimit të Masave Disiplinore, në Ministrinë e Drejtësisë në datën 09.11.2018, por nuk ka marrë përgjigje lidhur me vendimin e këtij komisioni brenda afatit ligjor. Në këto kushte, ai i është drejtuar me ankesë Zyrës së Bashkëqeverisjes dhe Institucionit të Avokatit të Popullit.

Ndërsa, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, e vënë në lëvizje nga Zyra e Bashkëqeverisjes, ka realizuar një takim me ankuesin A. P. në datën 04.02.2019. Procesverbali i mbajtur me shkrim dore për këtë takim është firmosur nga tre punonjës të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe nga A. P. Ky i fundit ka kërkuar ngritjen e komisionit për të rishqyrtuar masat disiplinore të dhëna padrejtësisht ndaj tij dhe rikthimin në punë. Ndërsa punonjësit e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve janë shprehur se mbeten në pritje të mbledhjes së Komisionit të Apelimit të Masave Disiplinore për të propozuar rishikimin e masave, në mënyrë që të ngrihet komision në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve dhe t'i jepet zgjidhje çështjes.

Me shkresën me nr. A-10/2 Prot., datë 23.07.2019, Komisioni i Apelimit të Masave Disiplinore (KAMD) i ka kthyer përgjigje A. P., ku ndër të tjera shprehet se për arsye të organizimit, konkretisht të largimit të disa anëtarëve të KAMD, nuk është bërë i mundur trajtimi i ankesës së tij të datës 09.11.2018 dhe se nuk mund dalë me një vendimmarrje pas kalimit të afatit administrativ. Ankimi administrativ quhej i ezauruar dhe ai mund t'i drejtohej gjykatës kompetente, për rivendosjen e të drejtave të cënuara të pretenduara prej tij. Konstatohet se, në përgjigjen e kthyer nga Ministria e Drejtësisë, A. P. vihet në dijeni për të drejtën e ankimit në gjykatë, por jo për afatin e ankimit, detyrim ky i përcaktuar në nenin 99/2, shkronja iii) të Kodit të Procedurës Administrative ku parashikohet se: “*Akti administrativ i shkruar në letër ose elektronik përmban: të drejtën e ankimit, përfshirë organin publik apo gjykatën ku mund të paraqitet ankimi, mjetet e ankimit, afatin dhe mënyrën e përlogaritjes së tij për paraqitjen e ankimit*”.

Në këto rrethana, A. P. i është drejtuar me padi kundër veprimit administrativ, Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë.

Sikurse evidentohet qartë nga dokumentacioni i administruar, ish punonjësi i policisë A. P. është orientuar t'i drejtohet gjykatës për të vendosur në vend të drejtën e tij, kur nga vetë Ministria e Drejtësisë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve pranohet se nuk është marrë në shqyrtim ankimi i tij dhe nuk i është kthyer përgjigje brenda afatit ligjor, duke mos u respektuar në këtë mënyrë e drejta për një proces të rregullt ligjor. Vetë i dëmtuari ka qenë i interesuar që problemi të zgjidhej me mirëkuptim brenda strukturave të sistemit të burgjeve. Në këtë rast nuk ka patur asnjë pengesë ligjore për Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve për të rishikuar masat disiplinore. Përkundrazi, Kodi i Procedurës Administrative parashikon se një akt administrativ i paligjshëm mund të anulohet apo shfuqizohet, kryesisht nga organi publik që ka në kompetencë të nxjerrë aktin, me qëllim rivendosjen e ligjshmërisë (neni 109, 113 dhe 114). Gjithashtu, organi publik që ka nxjerrë aktin mund të konstatojë në çdo kohë pavlefshmërinë absolute të aktit (neni 108, 110 dhe 111). Shmangia e shfrytëzimit të hapësirave ligjore për të gjetur zgjidhje për këtë rast apo raste të ngjashme, i heq mundësinë vetë strukturave të sistemit të burgjeve për të konstatuar nëse masat disiplinore janë të bazuara ose jo, largon nga radhët e administratës një punonjës me përvojë për të cilin është investuar kohë të përgatitet dhe në të njëjtën kohë, ul besimin tek punonjësit e tjerë për vlerësimin e meritave. Po ashtu ky është një proces që ngarkon buxhetin me detyrimet e caktuara nga gjykata.

Rregullat lidhur me ekzekutimin e masës disiplinore janë të përcaktuara në nenet 69 dhe 72 të Urdhrit të Ministrit të Drejtësisë Nr. 3125/1, datë 4.9.2009 "Për miratimin e rregullores *"Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për marrëdhënien e punës, trajnimin, ecurinë në karrierë dhe dhënien e masave disiplinore për punonjësit e policisë së burgjeve"*. Pikat 2 dhe 3 të nenit 69 parashikojnë se, efektet e masës disiplinore fillojnë pasi të ketë përfunduar procesi disiplinor, ku përfshihen procedurat përkatëse të apelimit dhe pasi të jetë dhënë vendimi përfundimtar. Masa disiplinore, për të cilën është bërë ankimi nga punonjësi ekzekutohet dhe vendoset në dosjen personale të tij si dhe regjistrohet në sistemin e të dhënave nga strukturat përkatëse të personelit, pasi të jetë marrë vendimi përfundimtar nga eprori, Komisioni i Apelimit ose gjykata. Ndërsa në pikat 3 dhe 4 të nenit 72 parashikohet se, masa disiplinore nuk mund të jepet nëse nuk i është komunikuar me shkrim punonjësit brenda 5 ditëve pune nga marrja e vendimit. Masa disiplinore nuk ekzekutohet kur nga momenti i ankimit të punonjësit kanë kaluar 60 ditë dhe punonjësit nuk i është njoftuar me shkrim vendimi i Komisionit të Apelimit.

Në interpretim të dispozitave të sipërpërmendura, në kushtet e mungesës të një vendimi përfundimtar nga Komisioni i Apelimit të Masave Disiplinore dhe nënshkrimit përkatës që provon se vendimi është komunikuar me shkrim, masat disiplinore të dhëna ndaj A. P. nuk duhet të ishin ekzekutuar.

Këto rregulla janë në kontradiktë me pikën 4 të nenit 69 të po kësaj Rregullore ku thuhet se: "*Në çdo rast, masa disiplinore ekzekutohet brenda 30 ditëve nga komunikimi i saj ose nga marrja e vendimit nga eprori apo Komisioni i Apelimit*". Sipas kësaj norme, masa disiplinore mund të ekzekutohet edhe brenda 30 ditëve nga marrja e vendimit nga eprori, pavarësisht mospërfundimit të procesit të ankimit.

Po ashtu, edhe sa i përket vënies në dijeni të vendimeve për dhënien e masave disiplinore, konstatojmë që janë parashikuar afate të ndryshme. Konkretisht në pikën 4 të nenit 36 të Ligjit Nr.10032, datë 11.12.2008 "*Për Policinë e Burgjeve*" thuhet se: "*Vendimi për*



*masën disiplinore duhet t'i komunikohet me shkrim punonjësit të Policisë së Burgjeve brenda 5 ditëve pune nga marrja e tij, duke e vënë në dijeni njëkohësisht edhe për të drejtën e tij të ankimit për vendimin*". Ndërsa në pikën 1 të nenit 61 të Urdhrit Nr. 3125/1, datë 4.9.2009 thuhet se: "*vendimi për dhënien e masës disiplinore duhet t'i komunikohet me shkrim brenda tri ditëve pune nga marrja e vendimit vetë punonjësit të policisë*", duke sjellë në këtë mënyrë një konfuzion në zbatimin e procedurës respektive dhe nga ana tjetër cenon të drejtën për një proces të rregullt ligjor.

E drejta për një proces të rregullt ligjor sanksionohet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, më konkretisht në nenin 42/1 ku thuhet se: "*Liria, prona dhe të drejtat e njohura me Kushtetutë dhe me ligj nuk mund të cenohen pa një proces të rregullt ligjor*". Gjykata Kushtetuese ka theksuar se e drejta e individit për një proces të rregullt ligjor, e parashikuar në nenin 42 të Kushtetutës, nuk është e kufizuar vetëm në procesin gjyqësor, por edhe në atë me karakter disiplinor administrativ. Në këtë kuptim, ajo është shprehur se çdo organ i pushtetit publik, gjatë ushtrimit të funksionit të tij kushtetues e ligjor, është i detyruar të respektojë standardet e gjithëpranuara demokratike, të cilat kanë gjetur pasqyrimin e tyre në Kushtetutë. Njohja paraprake e personit, ndaj të cilit kërkohet të merret masë administrative, me materialet që e ngarkojnë atë me përgjegjësi, respektimi i të drejtës për t'u dëgjuar dhe mbrojtur, si me anën e dhënies së sqarimeve paraprake ashtu dhe gjatë shqyrtimit të çështjes, janë disa nga elementet bazë që garantojnë të drejtën kushtetuese të cilitdo për një proces të rregullt, si një e drejtë themelore. E drejta për t'u dëgjuar, si pjesë e të drejtës së mbrojtjes, garantohej edhe në procesin administrativ përpara çdo organi, pavarësisht nga instanca dhe rëndësia e tij. Kjo realizohet nëpërmjet pjesëmarrjes së vetë individit në proces dhe nëpërmjet parashtrimit të argumenteve prej tij, ose avokatit të zgjedhur. (*shih vendimin nr.76, datë 25.04.2002 dhe nr. 29 datë 27.06.2013 të Gjykatës Kushtetuese*).

Për sa më lart, bazuar në nenin 63, pika 3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku thuhet se: "*Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut*" si dhe në mbështetje të nenit 21/b të ligjit nr.8454 dt.04.02.1999 "*Për Avokatin e Popullit*" i ndryshuar ku përcaktohet se: "*Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që, sipas tij, ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive.*"

### **REKOMANDOJMË:**

- Zbatimin në përputhje me legjislacionin të procedurës për dhënien e masës disiplinore ndaj punonjësit të policisë së burgjeve.
- Ndryshimin e neneve 61, 69 dhe 72 të Urdhrit të Ministrit të Drejtësisë Nr. 3125/1, datë 4.9.2009, Për miratimin e rregullores "*Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për marrëdhënien e punës, trajnimin, ecurinë në karrierë dhe dhënien e masave disiplinore për punonjësit e policisë së burgjeve*", në përputhje me Ligjin Nr. Nr.10032, datë 11.12.2008 "*Për Policinë e Burgjeve*".

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do merrni në zbatim të këtij rekomandimi, na vini në dijeni brenda afatit ligjor 30 ditor, të parashikuar në nenin 22 të ligjit nr. 8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”.

*Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,*

**AVOKATI I POPULLLIT**

**Erinda BALLANCA**